

## **PROCEDURA E FITIMIT TË SHETËSISË SË KOSOVËS**

### **Procedurat e fitimit te shtetësisë me lindje ne baze te origjinës kur te dy prindërit janë shtetase te Republikës se Kosovës**

Shtetësia e Republikës se Kosovës fitohet me lindje nëse ne kohen e lindjes se fëmijës te dy prindërit janë shtetase te Republikës se Kosovës.

Regjistrimi i Shtetësisë ku vendi i lindjes se fëmijës dhe vendbanimi i prindërve është i njëjte, behet sipas detyrës zyrtare nga Zyrtari i Gjendjes Civile ne komunën përkatëse.

Regjistrimi i Shtetësisë se fëmijës kur vendi i lindjes se fëmijës dhe vendbanimi i prindërve është i ndryshëm behet ne vendbanimin e prindërve me kërkesën e palës (prindërit apo kujdestaret).

**Kërkesës duhet bashkangjitur këto dëshmi:**

- Certifikatën e lindjes se fëmijës
- Certifikata nga regjistri i Gjendjes Civile ose ndonjë dëshmi tjetër te vlefshme qe dëshmon shtetësinë e prindërve ne Kosove.

### **Procedurat e fitimit te shtetësisë me lindje ne Kosovë ku njëri prind është shtetas i Kosovës**

Kërkesa për regjistrimin e shtetësisë me lindje ne Kosove ku njeri prind ka shtetësinë e Kosovës, parashtrohet personalisht apo përmes njërit prind për persona te mitur sipas vendbanimit te parashtruesit te kërkesës ne Zyrën komunale te Gjendjes Civile ne Republikën e Kosovës.

**Kërkesës duhet bashkangjitur këto dëshmi:**

- Certifikata e lindjes se fëmijës
- Certifikata nga regjistri i Gjendjes Civile ose ndonjë dëshmi tjetër te vlefshme qe dëshmon shtetësinë e prindërve ne Kosove.
- Pajtimi i fëmijës me te vjetër se 14 deri ne 18 vjeç.
- Pajtimi me shkrim i prindit me shtetësi tjetër i vërtetuar, ne këtë rast Komisioni për Shtetësi i MPB-se, siguron qe fëmija te mos mbetet pa shtetësi nëse prindi ne fjale nuk e jep pajtimin e ti/saj/

### **Procedura e fitimit te shtetësisë kur fëmija është i lindur jashtë**

## **Kosovës dhe prindi tjetër është me shtetësi te panjohur ose pa shtetësi**

Regjistrimi i shtetësisë kur fëmija është i lindur jashtë Kosovës dhe njeri prind ka shtetësinë e Kosovës, ndërsa prindi tjetër është me shtetësi te panjohur ose pa shtetësi, kërkesa parashtrohet personalisht apo përmes njërit prind për persona te mitur sipas vendbanimit te parashtruesit te kërkesës ne Zyrën komunale te Gjendjes Civile ne Republikën e Kosovës.

**Kërkesë duhet bashkangjitur këto dëshmi:**

- Certifikatën e lindjes se fëmijës
- Certifikatën nga regjistri i Gjendjes Civile te prindit ose ndonjë dëshmi qe dëshmon shtetësinë e tij ne Kosove.
- Pajtimi i fëmijës me te vjetër se 14 deri ne 18 vjeç.
- Pajtimi me shkrim i prindit qe nuk e posedon shtetësinë e Kosovës i vërtetuar, ne këtë rast Komisioni për Shtetësi i MPB-se, siguron qe fëmija te mos mbetet pa shtetësi nëse prindi ne fjale nuk e jep pajtimin e ti/saj/

**Procedura e fitimit te shtetësisë nëse fëmija është i lindur jashtë Kosovës dhe prindi tjetër ka shtetësi tjetër por te dy prindërit pajtohen me shkrim qe fëmija te fitoj shtetësinë e Kosovës**

Kërkesa për regjistrimin e shtetësisë kur fëmija është i lindur jashtë Kosovës dhe prindi tjetër ka shtetësi tjetër por te dy prindërit pajtohen me shkrim qe fëmija te fitoj shtetësinë e Kosovës parashtrohet përmes njërit prind sipas vendbanimit te parashtruesit te kërkesës ne Zyrën komunale te Gjendjes Civile ne Republikën e Kosovës. Kjo dispozite duhet te ushtrohet para se fëmija te ketë mbushur moshën 14 vjeçare.

**Kërkesë duhet bashkangjitur këto dëshmi:**

- Certifikatën e lindjes se fëmijës
- Certifikatën nga regjistri i Gjendjes Civile te prindërve ose ndonjë dëshmi tjetër te vlefshme qe dëshmon shtetësinë e prindërve.
- Pajtimi me shkrim i prindërve i vërtetuar, ne këtë rast Komisioni për Shtetësi i MPB-se, siguron qe fëmija te mos mbetet pa shtetësi nëse do njeri prej prindërve nuk e jep pajtimin e ti/saj/.

**Fitimi i shtetësisë me lindje ne territorin e Republikës se Kosovës**

Ne rastet kur fëmija është gjetur ose është lindur ne territorin e Republikës se

**Kosovës prindërit të cilët janë të panjohur, atëherë ai e fiton shtetësinë e Republikës së Kosovës me rastin e regjistrimit në Regjistrin e Lindjes dhe regjistrohet sipas detyrës zyrtare në Regjistrin e Shtetësisë.**

**Procedura e fitimit të shtetësisë kur fëmija është i lindur në Kosovë ndërsa prindërit kanë shtetësi tjetër por kanë leje qëndrimit të vlefshëm në Kosovë**

Ne rastet kur fëmija është i lindur brenda territorit të Republikës së Kosovës ndërsa prindërit e tij kanë shtetësi tjetër por kanë leje qëndrimit të vlefshëm në Republikën e Kosovës, fëmija mund të fitojë shtetësinë e Kosovës me pëlqimin e të dy prindërve.

**Kërkesës për fitimin e shtetësisë duhet bashkangjitur:**

- **Certifikata e lindjes së fëmijës**
- **Kopjet e dokumenteve të identifikimit dhe dëshmi e vlefshme të qëndrimit në Republikën e Kosovës për të dy prindërit.**
- **Pajtimi me shkrim i prindërve i vërtetuar, në këtë rast Komisioni për Shtetësi të MPB-së, siguron që fëmija të mos mbetet pa shtetësi nëse ndonjëri prej prindërve nuk jep pajtimin.**

**Procedura e aplikimit për fitimin e shtetësisë së Kosovës me natyralizim**

**Kërkesa për fitimin e shtetësisë së Kosovës me natyralizim paraqitet nga personi i huaj i moshës madhore personalisht në Zyrën e Gjendjes Civile sipas vendbanimit të parashtruesit të kërkesës në Republikën e Kosovës.**

**Kërkesës duhet bashkangjitur këto dëshmi:**

- **Certifikata e lindjes dhe martesës për personat e martuar**
- **Dëshmi i lejes së vlefshme të qëndrimit për 5 vite në Republikën e Kosovës**
- **Dëshmi që i ka përmbushur të gjitha detyrimet financiare (dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe nga Zyra Komunale e Tatimit në Prone mbi përmbushjen e obligimeve tatimore).**
- **Dëshmi për banimin adekuat për parashtruesin e kërkesës dhe vartëseve të tij**
- **Dokument që dëshmon njohuri elementare në një të njëri prej gjuhëve zyrtare**
- **Dëshminë që nuk është nën hetime penale dhe që nuk është i dënuar për vepra penale të lëshuar nga gjykata kompetente e Republikës së Kosovës si dhe organi kompetent i shtetit të huaj shtetas i të cilit është parashtruesi i kërkesës apo shtetit në të cilin ai/ajo ka pasur vendbanimin e fundit jo më të vjetër se 6 muaj.**
- **Dëshmi që posedon mjete të mjaftueshme materiale për të siguruar jetesën e**

- vet dhe personave për mbajtjen e te cilëve është përgjegjës pa shfrytëzuar skema sociale
- Dokument i vlefshëm identiteti ne kopjen e vërtetuar me fotografën e poseduesit qe duket qarte.
  - Deklaratën e betimit me shkrim qe e pranon rendin kushtetues dhe juridik te Republikës se Kosovës
  - Taksa administrative ne raste te fitimit ne shume prej 150 euro.

### **Procedura e aplikimit për fitim e shtetësisë se Kosovës me natyralizim i/e bashkëshortit**

Kërkesa e personit te huaj i cili është bashkëshort i shtetasit te Kosovës për fitimin e shtetësisë me natyralizim parashtrohet personalisht apo nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ne Zyrën e Gjendjes Civile sipas vendbanimit te parashtruesit te kërkesës ne Republikën e Kosovës.

**Kërkesës duhet bashkangjitur këto dëshmi:**

- Certifikata e lindjes dhe martesës e cila dëshmon se paku 3 vite lidhje te vlefshme martesore me shtetasin e Kosovës.
- Dëshmi për banimin e ligjshëm ne Republikën e Kosovës për se paku 1 vit para se te behet parashtrimi i kërkesës.
- Dëshmi qe i ka përmbushur te gjitha detyrimet financiare (dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe nga Zyra Komunale e Tatimit ne Prone mbi përmbushjen e obligimeve tatimore).
- Dëshminë qe nuk është nen hetime dhe qe nuk është i dënuar për vepra penale e lëshuar nga gjykata kompetente e Republikës se Kosovës si dhe organi kompetent i shtetit te huaj shtetas i te cilit është parashtruesi i kërkesës apo shtetit ne te cilin ai/ajo ka pasur vendbanimin e fundit, jo me te vjetër se 6 muaj.
- Dëshmi qe posedon mjete te mjaftueshme materiale për te siguruar jetesën e vet dhe personave për mbajtjen e te cilëve është përgjegjës pa shfrytëzuar skema sociale.
- Dokument i vlefshëm identifikimi.
- Deklaratën e betimit me shkrim qe e pranon rendin kushtetues dhe juridik te Republikës se Kosovës
- Taksa administrative ne raste te fitimit ne shume prej 150 euro

**Procedura e aplikimit për fitimin e shtetësisë se Kosovës me natyralizim i fëmijës se mitur te personit te natyralizuar**

**Fëmija i mitur nen moshën 18 vjeçare i parashtruesit te kërkesës për natyralizim e fiton shtetësinë e Republikës se Kosovës me natyralizim ne baze te natyralizimit te prindërve te tij. Parashtrimi i kërkesë për te miturin duhet ti bashkëngjitet kërkesës për natyralizim te prindit dhe te parashtrohet nga prindi i tij apo nëpërmjet përfaqësuesit ligjor ne Zyrën e Gjendjes Civile ne komunën ku banon parashtruesi i kërkesës.**

**Kërkesës duhet bashkangjitur këto dëshmi:**

- **Certifikata e lindjes se fëmijës**
- **Dokumente zyrtare te vlefshme te prindërve, me te cilët dëshmohet identiteti i tyre**
- **Pajtimi me shkrim i prindërve i vërtetuar**
- **Pajtimi i fëmijës me te vjetër se 14 deri ne 18 vjeç**
- **Taksa administrative ne shume prej 50 euro.**

**Kjo procedurë vlen edhe për personat e mitur te adaptuar.**

**Procedura e aplikimit për fitimin e shtetësisë me natyralizim te personit qe ka humbur shtetësinë e Kosovës**

**Kërkesa për fitimin e shtetësisë me natyralizim për personin qe ka humbur shtetësinë e Kosovës me lirim nga shtetësia parashtrohet personalisht apo përmes njërit prind për personat e mitur ne Zyrën e Gjendjes Civile, sipas vendbanimit te fundit te parashtruesit te kërkesë ne Republikën e Kosovës.**

**Kërkesës duhet bashkangjitur këto dëshmi:**

- **Certifikatën e lindjes**
- **Certifikatën nga regjistri i Gjendjes Civile te prindit**
- **Kopje te dokumenteve te identifikimit te te dy prindërve**
- **Dëshmi qe i ka përmbushur te gjitha detyrimet financiare (dëshmi nga Administrata Tatimore e Kosovës dhe nga Zyra Komunale e Tatimit ne Prone mbi përmbushjen e obligimeve tatimore).**
- **Dëshminë qe nuk është nen hetime dhe qe nuk është i dënuar për vepra penale e lëshuar nga gjykata kompetente e Republikës se Kosovës si dhe organi kompetent i shtetit te huaj shtetas i te cilit është parashtruesi i kërkesës apo shtetit ne te cilin ai/ajo ka pasur vendbanimin e fundit, jo me te vjetër se 6 muaj.**
- **Dëshmi qe posedon mjete te mjaftueshme materiale për te siguruar jetesën e vet dhe personave për mbajtjen e te cilëve është përgjegjës pa shfrytëzuar skema sociale.**

- Deklaratën e betimit me shkrim qe e pranon rendin kushtetues dhe juridik te Republikës se Kosovës
- Pajtimi me shkrim i prindërve i vërtetuar
- Pajtimi i fëmijës me te vjetër se 14 deri ne 18 vjeç
- Taksa administrative ne shume prej 150 euro, ndërsa për persona te mitur ne shumën prej 50 euro.

### **Aplikimi në misionin Diplomatik apo Konsullor te Republikës së Kosovës**

Ne rastet kur parashtruesi i kërkesës i ka vendbanimin jashtë Republikës se Kosovës kërkesa mund ti parashtrohet përfaqësive diplomatike ose konsullore te Republikës se Kosovës qe kanë juridiksion mbi vendbanimin e parashtruesit te kërkesës. Përfaqësia diplomatike ose konsullore ka për detyre qe kërkesën e dertuar ta përcjelle tek organi kompetent. Ne baze te kërkesës nëpunësit konsullor mund te ndihmojnë Ministrin e Punëve te Brendshme me marrjen e dëshmime qe kane te bëjnë me kërkesën, ne pajtim me kompetencat e tyre qe dalin nga Ligji për Shërbimin Konsullor te Misioneve Diplommatike dhe Konsullore te Republikës se Kosovës.

Shqyrtimi dhe vendosja e kërkesës i nënshtrohet procedurave te përcaktuara me Udhëzim Administrativ, si dhe Udhëzimet tjera te Ligjit për Shtetësinë e Kosovës.

## **PROCEDURA E HUMBJES SË SHITËSISË SË KOSOVËS ME LIRIM**

### **Procedurat e aplikimit për humbjen e shtetësisë së Kosovës me lirim nga shtetësia për personat madhor**

**Kërkesa për humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim nga shtetësia për persona madhor parashtrohet në Zyrën e Gjendjes Civile personalisht sipas vendbanimit të fundit të parashtruesit të kërkesës në Republikën e Kosovës.**

**Kërkesës duhet bashkëgjitur këto dëshmi:**

- Dëshminë për posedimin e shtetësisë të ndonjë shteti tjetër apo garancionin (provën) se kjo shtetësi do të jepet
- Certifikatën e lindjes
- Kopje të dokumentit të identifikimit
- Dëshmi për vendbanimin në shtetin e huaj ku banon
- Dëshmi për vendbanimin e fundit në Republikën e Kosovës
- Dëshmi që i ka përmbushur detyrimet financiare ndaj shtetit (dëshmi nga Administrata tatimore e Kosovës dhe nga zyra komunale e tatimit në prone mbi përmbushjen e obligimeve tatimore)
- Dëshminë nga qendra komunale për punë sociale që i ka përmbushur të gjitha detyrimet financiare ndaj personave për ushqim dhe mbajtje të cilëve është përgjegjës para ligjit
- Dëshminë që nuk është nën hetime penale dhe që nuk është i dënuar për vepra penale të lëshuar nga gjykata kompetente e Republikës së Kosovës si dhe organi kompetent i shtetit të huaj shtetas i të cilit është parashtruesi i kërkesës apo shtetin në të cilin ai /ajo ka pasur vendbanimin e fundit, jo më të vjetër se 6 muaj
- Dëshmi nën betim që shtetasi që kërkon lirim nga shtetësia nuk është nëpunës civil, gjykatës, prokuror publik, pjesëtar i policisë së Kosovës, pjesëtar i forcës së sigurisë së Kosovës ose pjesëtar i Agjencionit të Kosovës për Inteligjencë.
- Në rast se komisionet vendos për lirim të shtetasit nga shtetësia e Republikës së Kosovës shtetasi në fjalë është i obliguar të prezantojë dëshminë për pagesën e taksave administrative në shumë prej 150 euro.
- Të gjitha dokumentet e ofruara si dëshmi duhet të jenë të përkthyer në ndonjërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë.

### **Procedurat e aplikimit për humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim nga shtetësia i/e të miturve**

**Kërkesa për humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim nga shtetësia e të miturve parashtrohet përmes prindërve apo njërit prind dhe behet në të njëjtën kërkesë të parashtruar nga prindërit apo prindi në Zyrën e Gjendjes Civile sipas vendbanimit (të fundit) të parashtruesit të kërkesës në Republikën e Kosovës.**

**Kërkesës duhet bashkëgjitur këto dëshmi:**

- Dëshminë për posedimin e shtetësisë të ndonjë shteti tjetër apo garancionin (provën) së kjo shtetësi do të jepet
- Certifikatën e lindjes së të miturit
- Certifikatën nga regjistrat e gjendjes civile të prindërve
- Dëshmi për vendbanimin/ vendqëndrimin të shtetit të huaj ku banon
- Dëshmi për vendbanimin e fundit të prindërve në Republikën e Kosovës
- Kopja e dokumentit të identifikimit të të miturit nëse e posedon
- Kopjen e dokumentit të identifikimit të të dy prindërve
- Deklaratën e pajtimit me shkrim nga të dy prindërit e vërtetuar
- Pajtimi i të miturit me i vjetër se 14 deri në 18 vjet.
- Në rast se përkujdesjen ndaj fëmijës së mitur e ka njeri prind dëshmitë duhet të plotësohen vetëm nga njeri prind që e ka përkujdesjen e fëmijës së mitur. Në këtë rast kërkesës duhet të bashkëgjitet edhe dëshmia me të cilin vërtetohet se prindit në fjalë i është besuar përkujdesja ndaj fëmijës së mitur
- Në rast se komisionet vendosin për lirim e fëmijës së mitur nga shtetësia e Republikës së Kosovës, prindërit apo prindi i fëmijës është i obliguar të prezantojë dëshminë për pagesën e taksave administrative në shumë prej 50 euro.
- Të gjitha dokumentet e ofruara si dëshmi duhet të jenë të përkthyer në ndonjërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë.
- Kjo procedurë vlen edhe për fëmijët e adaptuar

**Procedurat e aplikimit për humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim, të fëmijëve sipas nenit 7.2 të ligjit për shtetësinë e Kosovës**

Kërkesa për humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës me lirim të fëmijës sipas nenit 7.2 të Ligjit për Shtetësinë e Kosovës (në rast se të paktën një prind i fëmijës identifikohet para se fëmija të ketë mbushur moshën 7 vjeçare dhe prindi në fjalë nuk është shtetas i Republikës së Kosovës, me kërkesë të prindit fëmija e humb shtetësinë e Republikës së Kosovës me kushte që me humbjen e shtetësisë së Republikës së Kosovës fëmija të mos mbetet pa shtetësi) behet nga prindërit apo njeri prind në Zyrën e Gjendjes Civile sipas vendbanimit të fëmijës në Republikën e Kosovës.



**Kërkesës duhet ti bashkëngjiten dëshmitë si ne vijim:**

- **Certifikatën e lindjes se fëmijës**
- **Dëshminë për vërtetimin e atësi/amësisë**
- **Dëshminë për posedimin e shtetësisë, te shtetit shtetas te te cilit janë prindërit apo njeri prind**
- **Garancionin (provën) se fëmijës do ti jepet shtetësia e prindërve apo njërit prind**
- **Kopjen e dokumentit te identifikimit te te dy prindërve apo njërit prind**
- **Kopja e dokumentit te udhëtimit te fëmijës nëse e posedon**
- **Te gjitha dokumentet e ofruara si dëshmi duhet te jene te përkthyer ne ndonjëren nga gjuhët zyrtare ne Kosove**
- **Ne rast se komisionet vendosin për humbjen e shtetësisë se Republikës se Kosovës te fëmijës, prindërit apo prindi i fëmijës është i obliguar te prezantoj dëshminë për pagesën e taksave administrative ne shume prej 50 euro.**

### **Aplikimi në misionin Diplomatik apo Konsullor të Republikës së Kosovës**

Ne rastet kur parashtruesi i kërkesës i ka vendbanimin jashtë Republikës se Kosovës kërkesa mund ti parashtrohet përfaqësisë me te afërt diplomatike ose konsullore te Republikës se Kosovës. Përfaqësia diplomatike ose konsullore ka për detyre qe kërkesën e parashtruar tija përcjelle MPB (Zyra për Shtetësi).

Aplikimi ne përfaqësi diplomatike apo konsullore do te behet ne kohen kur do te bëhen funksionale përfaqësitë diplomatike apo konsullore te Republikës se Kosovës.

### **Shqyrtimi i kërkesës për humbjen e shtetësisë se Kosovës me lirim**

Shqyrtimi i kërkesës për humbjen e shtetësisë se Kosovës me lirim behet nga Komisioni për Shtetësi i MPB-se.

Komisioni për shtetësi ne kuadër te MBP-se pas shqyrtimit te kërkesës me dokumentet e bashkangjitura nxjerr vendimin përkatës brenda 30 ditësh.

Pala e pa kënaqur kundër vendimit ka te drejte ankesë ne Komisionin për shqyrtimin e ankesave te shtetësisë ne kuadër te MPB-se brenda 30 ditësh. Kundër vendimit te komisionit për shqyrtimin e ankesave mund te iniciohet procedurë gjyqësore ne gjykatën kompetente.

### **Refuzimi i kërkeses për lirim nga shtetësia e Kosovës**

Komisioni për Shtetësi refuzon kërkesën për lirim nga shtetësia e Kosovës nëse

shtetasi qe kërkon lirim nga shtetësia është nëpunës civil, gjykatës, prokuror publik, pjesëtar i policisë se Kosovës, pjesëtar i Forcës se Sigurisë se Kosovës apo pjesëtar i Agjencisë se Kosovës për Inteligjence ose lirim nga shtetësia është në kundërshtim me interesat e Republikës se Kosovës, në veçanti me ato të sigurisë së brendshme dhe të jashtme ose të marrëdhënieve ndërkombëtare të Republikës se Kosovës.

## **Garancioni**

Me kërkesë të shtetasit i cili kërkon lirim nga shtetësia e Kosovës, Komisioni për shtetësi i MPB-se mund të lëshon shtetasit në fjale një garancion me të cilën garantohej se shtetasi i plotëson kushtet për lirim nga shtetësia sipas Ligjit për Shtetësinë e Kosovës dhe do të miratohet kërkesë për lirim nga shtetësia, nëse shtetasi në fjale paraqet dëshmi për fitimin e shtetësisë së një shteti tjetër, përkatësisht paraqet garancionin e lëshuar nga organi kompetent i shtetit tjetër se do të fitojë shtetësinë e atij shteti, nëse lirohet nga shtetësia e Republikës se Kosovës.